



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:264170
Datë: 28.05.2024
Numri i dokumentit: 05747135

KPPP.nr. 2051/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Compass IT Sh.P.K., me numër unik identifikues 810848137 dhe me seli në Prishtinë, rr. "Adrian Krasniqi", të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Arsim Krasniqi, avokat nga Prishtina, kundër debitorit Kuvendi i Republikës së Kosovës, me seli në Prishtinë, Sheshi Ibrahim Rugova, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 789/23 të datës 07.11.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Irfan I. Kërçagu me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 28.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Kuvendi i Republikës së Kosovës, ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 789/23 të datës 07.11.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Irfan I. Kërçagu, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Compass IT Sh.P.K., ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr. 789/23, të datës 07.11.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve; Faturës nr. 28/2023, e datës 25.09.2023, duke detyruar debitorin Kuvendi i Republikës së Kosovës, që në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas pranimit të këtij urdhri në emër të borxhit nga fatura e lartcekur t'ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 9,800.00 EUR (me shkronja: nëntë mijë e tetëqind euro), me kamatë ligjore 8% nga dita e caktimit të përmbartimit e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor me arsyetim se dokumenti në bazë të së cilit është marr vendimi përmbartues ose urdhri përmbartues nuk ka titull ekzekutiv ose tipare të përmbartueshmërisë. Ka shtuar se kreditori dhe debitori kanë nënshkruar marrëveshje për shërbime zhvillimi, mirëmbajtje dhe hosting i ue- faqes së Komisionit për ndihmë shtetërore, e cila kontratë është nënshkruar për një periudhë të caktuar kohore dhe për vlerën totale prej 4,400.00. Tutje, ka shtuar se përkundër njoftimit nga ana e debitorit që pas përfundimit të vlerës së përcaktuar të mos dërgoj fatura, kreditori ka dërguar faturën përtej shumës së përcaktuar me kontratë. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar në përgjigje ndaj prapësimit ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit me arsyetim se fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbartimor i ka të gjitha tiparet e përmbartueshmërisë dhe i është dërguar debitorit përmes postës me datë 26.09.2023 dhe i njëjti e ka pranuar përmes fletë kthesës postare të datës 28.09.2023, e që konsiderohet se dorëzimi i faturës është bërë me rregull. Ka shtuar se pretendimet e debitorit se kreditori nuk ka pasur të drejtë të dërgojë faturën e shërbimeve te debitori nuk qëndrojnë sepse kreditori dhe debitori në bazë të kontratës janë marrë vesh që komunikimet mund t'i dërgojnë përmes postës, email-it, ashtu që dërgesa e faturës është realizuar konform kësaj dispozite kontraktuale, si dhe në lidhje me vlerën e parashikuar si në kontratë palët janë pajtuar që kjo vlerë mund të ndryshojë varësisht nga kërkesa e organit kontraktues. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi, si dhe të obligohet debitori që të kompensojë shpenzimet procedurale për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumë prej 104.00 €.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është*

treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti faturë nr. 28/2023 i datës 25.09.2023, në bazë të së cilës është lejuar përmbarimi nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm sipas nenit 29.3 të LPP-së për faktin se fatura e lartcekur, nuk përmban vulën e pranimit të shkresave të debitorit si institucion publik e po ashtu nuk përmban nënshkrimin e personit të autorizuar të debitorit tek pranuesi i faturës. Ndërsa kreditori, nuk ka arritur të dëshmoj se në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme i'a ka dorëzuar faturën debitorit, kurse ky i fundit ka pranuar faturën në fjalë dhe se është pajtuar më përmbajtjen dhe lartësinë e të njëjtës. Rrjedhimisht, fatura si e tillë rezulton të jetë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga kreditori, andaj edhe nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm.

Gjykata pati parasysh pretendimet e kreditorit se dorëzimi i faturës i është bërë palës debitore përmes postës së rregullt, dhe atë konform dispozitave të LPK-së, por që dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore që rregullojnë çështjen e komunikimit të parashtrësive, vlejnë për komunikimin në mes të gjykatës dhe palës në procedurë, por jo edhe për komunikimin mes subjekteve ekonomike para inicimit të një procedure gjyqësore. Për më tepër, në dëshminë postare të ofruar nga kreditori, tek lloji i dërgesës, nuk është përshkruar që dërgesa ka të bëjë me faturën nr. 28/2023 mbi bazën e të cilës është lejuar përmbarimi, andaj debitori, nuk ka qenë paraprakisht i njoftuar me përmbajtjen e dërgesës para se të pranojë të njëjtën.

Nga të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilës Përmbaruesi Privat ka lejuar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundojë në tërësi.

Nga si më sipër, e në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2051/23, datë 28.05.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimet të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate